



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.38/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtaresen e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterëve në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, kështu që koalicioni LDK- AKR, dega në Ferizaj i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,300.00 (një mijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografimin e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 01.06.2017, në rrugën Varoshi në Ferizaj, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR të ngjitur në shtylla publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni LDK-AKR ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se lidhur me pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe urdhëresës së PZAP-it për të ndërmarrë

masa përmirësuese, LDK-AKR ka urdhëruar kandidatin që të ndërmarrë veprime përmirësuese, me çka është evituar shkelja e pretenduar me Ankesë.

Për të dëshmuar këtë, përgjigjes në ankesë u janë bashkangjitur edhe provat, fotot e vendeve nga ku janë larguar fotot, posterat e kandidatit.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni LDK-AKR kërkoi nga PZAP-i, pasi që është evituar shkelja e pretenduar të mos i shqiptojë gjobë subjektit politik ngase efekti i ankesë është arrietur me vet faktin se janë larguar posterët nga kandidati.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR është vendosur në shtylla publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që poster i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR është vendosur në shtylla publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe faktin për kundër të këtij fakti poster i kandidatit për

deputet nga ky koalicion është vendosur në shtylla publike. Po ashtu si rrethanë, Pzap-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë , ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.38/2017 më datën 06.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.